

Rasti "Drenica 1", gjykata
shpall të pafajshëm Sami
Lushtakun dhe të tjerët

FAQE 3



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com



facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR **ABBRUCH** GMBH
www.awr-abbruch.de

KOSOVA NUK KA MË KONTRATA LOBIMI NË SHBA: A ËSHTË KY PROBLEM?

FAQE 4-5



Kosova nuk ka më asnjë kontratë aktive lobimi në ShBA, ndërsa ekspertët ndahen nëse ky është dobësim i pranisë në

Uashington apo mundësi për ta forcuar diplomacinë. Për disa njohës të politikës amerikane, mungesa e kontratave të lobimit

është shenjë se Kosova ka shkurtuar praninë në Uashington në një kohë kur duhet ta forconte

**SIGURIA NË
FOKUS TË
TAKIMEVE TË
HAXHIUT DHE
KURTIT ME
ADMIRALIN
WIKOFF**

F. 7



**IPS KËRKON VEPRIME URGJENTE
KUNDËR ARMËVE TË PALIGJSHME**

F. 3



OPINION

**KRISTALET E REVOLTËS
SË SYZIFIT**

Lulëzim
ETEMAJ



AKTUALE



**KUSH JANË KANDIDATËT
PËR POZITËN E SEKRETARIT TË
PËRGJITHSHËM TË OKB-së?**

F. 2

**KRYESIA E BORDIT INDUSTRIAL
KËRKON QË USHAF TË MOS LIHET
JASHTË PARASHIKIMEVE
TË BUXHETIT SHTETËROR**

F. 3

EKONOMI



**DEFICITI TREGTAR I KOSOVËS RREDIT
NË 578.3 MILIONË EURO, BE-ja
MBETET PARTNERJA KRYESORE
TREGTARE**

F. 8

**OEK-u MBËSHTET SEKTORIN E
GURËTHYESVE NË ADRESIMIN
E SFIDAVE PËR LICENCIM**

F. 8

SPORT



**AGIM ADEMI: JEMI NË KONTAKTE
ME TRE FUTBOLLISTË QË LUAJNË
NË BUNDESLIGA**

F. 11

RENOVA
PUTZ
Maqedoni
Xhepçisht-Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +389 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
MITROVICË

Kolegji BIZNESI
www.kolegji.biznesi.com
info@kolegji.biznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n. Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

KUSH JANË KANDIDATËT PËR POZITËN E SEKRETARIT TË PËRGJITHSHËM TË OKB-së?

NJU-JORK - 28 KORRIK - Sekretari i 10 i përgjithshëm i Kombeve të Bashkuara do të zgjidhet këtë vit për një mandat pesëvjeçar, që nis më 1 janar 2027.

Më poshtë janë kandidatët që deri më tani kanë shpallur kandidaturën për të pasuar sekretarin e përgjithshëm në largim të OKB-së, Antonio Guterres.

Rafael Grossi

Rafael Grossi, 65 vjeç, diplomat karriere nga Argjentina, ka qenë gjatë gjashtë vjetëve të fundit drejtor i përgjithshëm i Agjencisë Ndërkombëtare për Energjinë Atomike (IAEA) - organi mbikëqyrës bërthamor i OKB-së. Grossi udhëhoqi negociatat për të ruajtur pjesë të marrëveshjes bërthamore të vitit 2015 me Teheranin, pasi presidenti amerikan, Donald Trump, i tërhoqi Shtetet e Bashkuara nga ajo marrëveshje në vitin 2018.

Kritikët e tij thonë se ai ka bërë lëshime të tepërta në përpjekje për të arritur marrëveshje me Iranin.

Baba i tetë fëmijëve, që flet disa gjuhë, Grossi ka rritur profilin e tij dhe të IAEA-s përmes angazhimit diplomatik në krizat ndërkombëtare.

Një nga arritjet e tij më të rëndësishme konsiderohet vendosja e një ekipi të vogël të IAEA-s në termocentralin bërthamor të Zaporizhjes në Ukrainë, i cili ndodhet nën kontrollin e forcave ruse.

Shumë diplomatë e shohin Grossin si favorit për postin e sekretarit të përgjithshëm të OKB-së, pasi për vite me radhë ka ruajtur marrëdhënie të mira me pesë anëtarët e përhershëm të Këshillit të Sigurimit të OKB-së, mbështetja e të cilëve është vendimtare për zgjedhjen në këtë post.

Rebeca Grynspan

Rebeca Grynspan, 70 vjeçe, e paraqet veten si një mbështetëse të reformave në sistemin shumëpalësh, e cila gjatë karrierës

së saj ka sfiduar pengesat gjinore dhe ka ruajtur besimin te Kombet e Bashkuara dhe misioni i tyre për paqe, zhvillim dhe të drejta të njeriut.

Ish-nënpresidente e Kosta Rikës dhe drejtoreshë e Konferencës së OKB-së për Tregtinë dhe Zhvillimin (UNCTAD), Grynspan tha se është tërhequr përkohësisht nga detyrat e saj deri në shtator, për të shmangur konfliktin e interesit gjatë fushatës. Nëse zgjidhet, ajo do të bëhej gruaja e parë në historinë e OKB-së që do të mbante postin e sekretares së përgjithshme.

Sipas saj, edhe pse gjatë drejtimit të UNCTAD-së është detyruar të bëjë kompromise mes jetës familjare dhe shërbimit publik, përvoja si gruaja e parë në krye të këtij institucioni ka ndikuar në mënyrën e saj të udhëheqjes.

“Nuk pres trajtim të veçantë. Dua trajtim të barabartë”, tha ajo për agjencinë e lajmeve Reuters. Ekonomiste me profesion, Grynspan e përshkruan veten si një “udhëheqëse me përvojë”, e cila do ta drejtonte OKB-në në mënyrë më fleksibile, përmes bashkëpunimit me partnerë të ndryshëm, duke mbrojtur njëkohësisht vlerat themelore të organizatës.

Michelle Bachelet

Michelle Bachelet, 74 vjeçe, ka qenë dy herë presidente e Kilit dhe ish-komisionare e lartë e OKB-së për të Drejtat e Njeriut. Ajo ka drejtuar gjithashtu, nga viti 2010 deri në vitin 2013, agjencinë e OKB-së për barazinë gjinore dhe fuqizimin e grave, UN Women. Edhe pse kandidatura e saj mbështetej nga Brazili dhe Meksika, në mars Kili e tërhoqi mbështetjen për Bacheletin, pas zhvendosjes së Qeverisë së vendit drejt së djathtës.

Bachelet është përballur me kritika nga konservatorët amerikanë për qëndrimin e saj në mbështetje të së drejtës për abort. Në prill, ambasadori i Shteteve të Bashkuara në OKB, Mike Waltz, duke iu bashkuar shqetësimeve të një senatori amerikan, la të kuptohej se nuk e konsideron atë



të përshtatshme për postin. Senatori republican, Pete Ricketts, deklaroi se Bachelet, gjatë mandatit si komisionare e lartë për të Drejtat e Njeriut, nuk bëri mjaftueshëm për t'i cilësuar si gjenocid veprimet e Kinës ndaj myslimanëve ujgurë.

Pekini, nga ana tjetër, nuk ka bërë publik qëndrimin e tij për kandidaturën e saj.

Macky Sall

Macky Sall, 64 vjeç, gjeolog me profesion, ishte president i Senegalit për 12 vjet, deri në vitin 2024. Sall është zotuar se do t'i mbështesë vendet në zhvillim që përballen me borxhe të mëdha dhe ka bërë thirrje për reformimin e Këshillit të Sigurimit të OKB-së, në mënyrë që vendet në zhvillim të kenë poste të përhershme në organin më të fuqishëm të organizatës. “Më shumë se kurrë, një multilateralizëm i ripërtërirë mbetet mënyra më e mirë për t’iu përgjigjur sfidave të një bote që po kalon transformime të thella”, ka shkruar ai në rrjetin social X.

Sall është nominuar nga Burundi. Nëse zgjidhet, ai do të bëhej sekretari i tretë i përgjithshëm afrikan i OKB-së, pas Boutros Boutros Ghalit dhe Kofi Annanit.

Maria Fernanda Espinosa

Maria Fernanda Espinosa, 61 vjeçe, ka qenë ministre e Punëve të Jashtme dhe ministre e Mbrojtjes në Ekuador, gjatë qeverisjes së ish-presidentit Rafael Correa.

Kandidatura e saj është paraqitur nga Antigua dhe Barbuda. Espinosa ka këshilluar gjithashtu Kombet e Bashkuara dhe organizata joqeveritare për çështje që lidhen me biodiversitetin, ndryshimet klimatike dhe politikat për popujt indigjenë. Ajo thotë se përvoja si ambasadore e Ekuadorit në OKB dhe si presidente e Asamblesë së Përgjithshme të OKB-së i ka dhënë njohuri të thella për funksionimin e organizatës. “Ofroj një kandidaturë të mbështetur në një bindje të thjeshtë: OKB-ja duhet ta riftojë guximin për të

përcaktuar prioritetet, disiplinën për t'i zbatuar ato dhe besimin politik për të vepruar me vendosmëri”, ka deklaruar ajo në dokumentin ku paraqet vizionin e saj.

Carolyn Allison Farida Rodrigues Birkett

Carolyn Allison Farida Rodrigues Birkett është diplomate karriere dhe ish-politikane. Që nga viti 2020 ajo shërben si përfaqësuese e përhershme e Guajanës në Kombet e Bashkuara. Më herët ajo është bërë gruaja e parë dhe personi i parë nga komunitetet indigjene që ka mbajtur postin e ministres së Punëve të Jashtme të Guajanës. Ajo ka mbajtur, gjithashtu, poste të larta në Organizatën e OKB-së për Ushqimin dhe Bujqësinë (FAO). Nëse zgjidhet, Rodrigues Birkett do të bëhej gruaja e parë dhe përfaqësuesja e parë e Karaibeve në krye të Kombeve të Bashkuara. Në platformën e saj, Rodrigues Birkett është zotuar ta bëjë OKB-në më efektive, duke forcuar parandalimin e konflikteve dhe duke avancuar veprimet kundër ndryshimeve klimatike.

Olara Otunnu

Olara Otunnu, diplomat dhe ish-nënshekar i përgjithshëm i Kombeve të Bashkuara, është nominuar nga Uganda. Në moshën 75-vjeçare, ai është kandidati më i moshuar në garën për postin e sekretarit të përgjithshëm të OKB-së.

Në dokumentin ku paraqet vizionin e tij, Otunnu thekson nevojën për të vazhduar reformat institucionale të OKB-së dhe thotë se prioriteti i tij i menjëhershëm do të ishte intensifikimi i përpjekjeve për t'u dhënë fund konflikteve të mëdha ndërkombëtare.

Ai është zotuar, gjithashtu, se do të punojë për krijimin e një organi që do të mbikëqyrte punën e OKB-së në fushën e inteligjencës artificiale dhe ka theksuar se lufta kundër ndryshimeve klimatike duhet të ecë përpara pa penguar zhvillimin ekonomik.

Zjarret dhe i nxehti ekstrem mbajnë Francën dhe Spanjën në alarm

PARIS, 28 KORRIK - Zjarrfikësit në Francë dhe në Spanjë vazhdojnë përpjekjet për t'i vënë nën kontroll zjarret masive pyjore që kanë detyruar dhjetëra mijëra njerëz të largohen nga shtëpitë e tyre.

Të dyja vendet po përgatiten, po ashtu, për një valë të re të të nxehtit që pritët ta

përkeqësojë situatën nga e mërkura.

Në Francë, zjarrfikësit arritën ta frenojnë përhapjen e zjarrit pranë qytetit të Bordosë gjatë natës.

Në Spanjë autoritetet lejuan banorët e nëntë prej 11 qyteteve të evakuuara në provincën Toledo, të kthehen në shtëpitë e tyre. Megjithatë,

zjarret vazhdojnë të djegin hapësira jashtë kontrollit në rajonin e Madridit dhe në provincat fqinje Avila dhe Toledo.

Një banor i evakuuar nga zjarret në Spanjë e përshkroi situatën si “një ferr i kuq”, duke thënë se njerëzit u larguan me nxitim, duke marrë me vete vetëm rrobat

që kishin veshur, raporton “Reuters”.

Presidenti francez Emmanuel Macron tha se vendi po përballët me situatën më të rëndë me zjarret pyjore që nga Lufta e Dytë Botërore. “Po përballemi me një zjarr pyjor krejtësisht të paprecedentë”, tha ai gjatë një vizite tek ekipet e emergjencës pranë Bordosë.



Sipas autoriteteve franceze, deri tani këtë vit janë djegur më shumë sipërfaqe pyjore se në të njëjtën periudhë të çdo viti që nga viti 2006.

IPS kërkon veprime urgjente kundër armëve të paligjshme

PRISHTINË, 28 KORRIK - Instituti për Paqe dhe Siguri (IPS) ka shprehur shqetësimin për rritjen e rasteve të përdorimit të armëve të vogla dhe të lehta në Kosovë, duke bërë thirrje për masa të menjëhershme për luftimin e posedimit të paligjshëm të armëve. Sipas një komunikate të IPS-së, përdorimi i armëve të zjarrit gjatë muajve dhe viteve të fundit ka rezultuar me dhjetëra persona të plagosur dhe

me humbje tragjike të jetëve njerëzore. Instituti vlerëson se, edhe 27 vjet pas përfundimit të luftës, armët vazhdojnë të jenë të pranishme në duart e qytetarëve dhe të përdoren në konflikte të përditshme, mosmarrëveshje personale, ahengje familjare dhe ngjarje të tjera që shpesh përfundojnë me pasoja fatale. “Prania e armëve të paligjshme nuk është vetëm

çështje e rendit publik, por një kërcënim serioz për sigurinë, jetën e qytetarëve dhe stabilitetin shoqëror”, thuhet në reagim. IPS kërkon shtim të operacioneve për identifikimin dhe konfiskimin e armëve të paligjshme, nisjen e një fushate kombëtare për dorëzimin vullnetar të armëve, hartimin e një strategjie të re shtetërore për reduktimin e armëve të vogla dhe të lehta si dhe

forcimin e edukimit dhe ndërgjegjësimit publik, veçanërisht tek të rinjtë. Po ashtu, Instituti ka bërë thirrje për bashkëpunim më të ngushtë ndërmjet institucioneve të sigurisë, sistemit të drejtësisë, shoqërisë civile dhe medieve në funksion të parandalimit të dhunës së armatosur. IPS u ka bërë thirrje qytetarëve që kanë armë pa leje t’i dorëzojnë ato



pranë institucioneve kompetente, duke theksuar se siguria ndërtohet përmes sundimit të ligjit, drejtësisë funksionale dhe kulturës së dialogut, e jo përmes armëve.

RASTI ‘DRENICA 1’, GJYKATA SHPALL TË PAFAJSHËM SAMI LUSHTAKUN DHE TË TJERËT

PRISHTINË, 28 KORRIK - Gjykata Themelore në Prishtinë ka liruar nga të gjitha akuzat ish-komandantin e UÇK-së, Sami Lushtakun, dhe shtatë persona të tjerë të përfshirë në rastin e njohur si “Drenica 1”, pas një procesi që zgjati mbi 13 vjet. Trupi gjykues ka vendosur që të gjithë të akuzuarit të shpallen të pafajshëm pasi, sipas gjykatës, nuk është gjetur asnjë provë që do ta dëshmonte fajësinë e tyre. “Nuk është gjetur asnjë provë që do ta vërtetonte fajësinë e të pandehurve”, është thënë gjatë shpalljes së vendimit nga Gjykata Themelore në Prishtinë.

Shpenzimet e procedurës penale bien në barrën e mjeteve buxhetore të gjykatës. Në këtë rast gjykimi ka vazhduar për pikën 16, 17 dhe 18 të aktakuzës ndaj Sami Lushtakut, Ismet Haxhës, Rrustem Rrukolli, Fatmir Mjaku, Rexhep Xhota, Skender Tahiri, Sheremet Jashari dhe Bajram Dibrani, për të cilët ishte veçuar procedura. Në këtë rast, në pikat e tjera të aktakuzës ngarkoheshin: Emrush Thaqi, Shemi Hajrizi, Sami Lushtaku, Sahit Jashari, Ismet Haxha, Mergim Lushtaku, Dardan Geci, Bashkim Dervisholli, Valon Behramaj, Argjent Behramaj, Yll Blakaj,

Gzim Ahmeti, Xhevdet Zena, Mervete Hasani-Lushtaku, Agim Ukaj, Ismail Dibrani, Sami Gjoka dhe Nexhib Shatri. Prokuroria pretendonte se ky grup ka kryer veprat penale të “pengimit të dëshmisë apo procedurës zyrtare” dhe “frikësim gjatë procedurës zyrtare”. Sipas aktakuzës, ata nga qershori 2013 deri në shtator 2015 i kanë detyruar dy dëshmitarë t’i ndryshojnë dëshmitë e tyre në rastin “Drenica 1”. Akuzat në rastin “Drenica 1” lidhen me keqtrajtim të civilëve në Likoc gjatë luftës. Për këtë rast janë dënuar disa persona.



KRYESIA E BORDIT INDUSTRIAL KËRKON QË USHAF TË MOS LIHET JASHTË PARASHIKIMEVE TË BUXHETIT SHTETËROR

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

FERIZAJ, 28 KORRIK - Kryesia e bordit industrial të Universitetit të Shkencave të Aplikuara ka reaguar për, siç ka thënë, mosparashikimin e buxhetit për Universitetin e Shkencave të Aplikuara në Ferizaj (USHAF) në Projektligjin për Buxhetin e Republikës së Kosovës. Në reagim thuhet se ky vendim dëmton një model të bashkëpunimit i cili ka kontribuar në zhvillimin

ekonomik. “Ky vendim nuk prek vetëm një institucion të arsimit të lartë, por dëmton një model të dëshmuar bashkëpunimi ndërmjet universitetit dhe sektorit privat, model i cili për vite me radhë ka prodhuar kadro profesionale të gatshme për tregun e punës dhe ka kontribuar drejtpërdrejt në zhvillimin ekonomik të vendit. Që nga themelimi i Bordit Industrial, komuniteti i biznesit ka qenë partner i pandashëm i USHAF-it. Përfaqësuesit e kompanive kanë marrë pjesë



aktive në hartimin dhe përditësimin e kurrikulave akademike, në proceset e akreditimit të programeve studimore, si dhe në ndërtimin e strategjive zhvillimore të universitetit. Çdo vendim me rëndësi strategjike është

ndërtuar mbi frymën e bashkëpunimit dhe konsultimit të vazhdueshëm ndërmjet universitetit dhe industrisë, duke krijuar një model unik që e lidh arsimin me nevojat reale të ekonomisë”, thuhet në reagim. Për këtë situatë ditë më parë ka reaguar edhe Universiteti i Shkencave të Aplikuara në Ferizaj. “Ne i bëjmë thirrje Qeverisë së Republikës së Kosovës, Ministrisë së Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit, si dhe deputetëve të Kuvendit të Kosovës që të

rishqyrtojnë këtë vendim dhe të sigurojnë mbështetjen e nevojshme buxhetore për Universitetin e Shkencave të Aplikuara në Ferizaj. Mbështetja e USHAF-it nuk është vetëm mbështetje për një universitet. Është mbështetje për arsimin e orientuar drejt praktikës, për industrinë vendore, për zhvillimin ekonomik, për punësimin e të rinjve dhe për të ardhmen e Kosovës”, është thënë në reagimin e Universitetit të Shkencave të Aplikuara në Ferizaj.

Vazhdon mbledhja e nënshkrimeve për ndryshimin e Kodit Penal



GJAKOVË, 28 KORRIK - Instituti i Kosovës për Drejtësi ka vazhduar mbledhjen e nënshkrimeve për nismën legjislative qytetare për ndryshimin dhe plotësimin e Kodit Penal të Republikës së Kosovës. Kjo nismë të martën ka vazhduar në komunën e Gjakovës, ku qytetarë të shumtë tashmë e kanë mbështetur me

nënshkrimin e tyre, ndërsa nismën e mbështeti edhe kryetari i komunës së Gjakovës, Ardian Gjini, duke e nënshkruar atë. Përmes kësaj nisme IKD propozon dy ndryshime konkrete në Kodin Penal. Propozimi i parë ka të bëjë me parashikimin shprehimisht si vepër penale të moszbatimit të vendimeve

të Gjykatës Kushtetuese. Propozimi i dytë ka të bëjë me sanksionimin penal të përdorimit të parasë publike me qëllim përfitimin elektoral gjatë periudhave zgjedhore dhe parazgjedhore. Për ta proceduar këtë nismë në Kuvendin e Kosovës nevojiten të paktën 10 mijë nënshkrime të qytetarëve.



KOSOVA NUK KA MË KONTRATA LOBIMI NË SHBA: A ËSHTË KY PROBLEM?

Kosova nuk ka më asnjë kontratë aktive lobimi në ShBA, ndërsa ekspertët ndahen nëse ky është dobësim i pranisë në Uashington apo një mundësi për ta forcuar diplomacinë. Për disa njohës të politikës amerikane, mungesa e kontratave të lobimit është shenjë se Kosova ka shkurtuar praninë në Uashington në një kohë kur duhet ta forconte atë

PRISHTINË, 28 KORRIK - Kosova sot nuk ka asnjë kontratë aktive lobimi të regjistruar në Shtetet e Bashkuara. Në vetvete, ky është vetëm një fakt. Por, në praktikë hap një debat më të gjerë: sa rëndësi ka lobimi për një shtet të vogël që mbështetet te Shtetet e Bashkuara si aleati i tij më i rëndësishëm politik dhe i sigurisë? Përgjigja nuk është njësoj për të gjithë.

Për disa njohës të politikës amerikane mungesa e kontratave të lobimit është shenjë se Kosova ka reduktuar shkurtuar praninë në Uashington në një kohë kur duhet ta forconte atë.

Të tjerë argumentojnë se problemi nuk janë firmat e lobimit, por mungesa e një strategjie të qartë të politikës së jashtme dhe e një diplomacie më aktive.

Debatu zhvillohet në një kohë kur marrëdhëniet në mes të Kosovës dhe ShBA-së kanë kaluar disa sproveda.

Dialogu Strategjik mes dy

vendeve, i paralajmëruar prej kohësh, nuk ka nisur ende.

Në vitet fundit zyrtarët amerikanë kanë kërkuar vazhdimisht edhe uljen e tensioneve në veri dhe përparim në dialogun me Serbinë, ndërsa kanë përsëritur se presin një partner të qëndrueshëm dhe funksional në Prishtinë.

Lobimi, përndryshe, nuk është një zëvendësim i diplomacisë, por në Uashington është bërë pjesë e mënyrës se si shumë qeveri ndërtojnë qasje te vendimmarrësit, organizojnë takime dhe promovojnë interesat e tyre politike, ekonomike apo të sigurisë.

Kosova nuk është e panjohur me këtë praktikë.

Që nga vitet 1990 dhe pas shpalljes së pavarësisë institucionet e Kosovës kanë angazhuar disa nga firmat më të njohura të lobimit në ShBA.

Për vite me radhë ato kanë ndihmuar në krijimin e kontakteve me administratat

amerikane, Kongresin dhe aktorë të tjerë me ndikim në Uashington. Që nga qershori i vitit 2024 kjo praktikë ka pushuar.

As Presidenca, as qeveria dhe as institucionet e tjera nuk figurojnë me kontrata aktive në regjistrin e Aktit të Regjistrimit të Agjentëve të Huaj (FARA) - ligji amerikan që kërkon regjistrimin e individëve dhe kompanive që përfaqësojnë interesa të huaja para institucioneve amerikane.

Radio Evropa e Lirë iu drejtua Presidencës së Kosovës, Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës, si dhe ministrit në detyrë të Punëve të Jashtme, Glauk Konjufca, me pyetje nëse Kosova planifikon të angazhojë sërish kompani lobimi në Shtetet e Bashkuara dhe si synon ta forcojë praninë e saj diplomatike atje, por deri në publikimin e këtij artikulli nuk mori asnjë përgjigje.

Një mjet që Kosova e la pas?

Për Petrit Selimin, ish-ministër i Jashtëm i Kosovës, mungesa e kontratave të lobimit nuk është një detaj administrativ. Sipas tij, ajo pasqyron një ndryshim më të thellë në mënyrën se si Kosova e ka trajtuar marrëdhënien me Uashingtonin. Ai kujton se lobimi ka qenë pjesë e politikës së jashtme të Kosovës që nga vitet 1990, për të vazhduar edhe pas shpalljes së pavarësisë më 2008,

kur institucionet e Kosovës kanë bashkëpunuar me kompani të njohura për të krijuar qasje te vendimmarrësit, për të organizuar takime dhe për të qenë në agjendën politike amerikane. "Ky nuk ka qenë luks, por nevojë jetike për shtete të vogla si Kosova", thotë Selimi për Radion Evropa e Lirë. Sipas tij, kjo nevojë është bërë edhe më e madhe në vitet e fundit, pasi mënyra se si funksionon Uashingtoni, nën administratën e presidentit Donald Trump, ka ndryshuar.

Përveç institucioneve tradicionale, rol më të madh kanë marrë rrjetet politike, këshilltarët dhe kompanitë private të lobimit, të cilat, sipas tij, shpesh kanë qasje më të drejtpërdrejta te vendimmarrësit. "Në vitet e fundit kemi pasur nevojë për kompani që ndihmojnë të hapen dyert", thotë Selimi. "Është asgjë më pak se tragjike dhe krejtësisht e pakuptueshme që Kosova e ka dobësuar praninë diplomatike vetjake në Ambasadë, ashtu edhe ndërveprimin me lobistë privatë amerikanë", shton ai.

Në vlerësimin e tij, problemi nuk është vetëm mungesa e një kontrate lobimi. Ai argumenton se Kosova ka shkurtuar njëkohësisht dy mekanizma që duhet të plotësojnë njëri-tjetrin: diplomacinë dhe lobimin.

Nëse do ta këshillonte sot Qeverinë e Kosovës, Selimi thotë se hapi i parë do të ishte forcimi i Ambasadës në Uashington me

staf kompetent. Krahas kësaj, ai propozon angazhimin e dy kompanive të specializuara lobiste - një për agjendën politike, ekonomike dhe të sigurisë, një tjetër për komunikim strategjik dhe diplomaci digjitale. Për të këto nuk janë shpenzime dytësore, por investime në aftësinë e Kosovës për t'i mbrojtur dhe promovuar interesat në kryeqytetin amerikan.

Diplomacia para lobimit

Ideja se Kosovës i mungojnë kompanitë e lobimit nuk i bind të gjithë.

Robin Brooks, ish-zyrtarë në Këshillin e Sigurisë Kombëtare të ShBA-së, argumenton se debati shpesh e mbivlerëson rolin e lobistëve dhe nënvlerëson atë të diplomacisë. Ajo thotë se diplomatët, e jo lobistët, duhet të jenë kanali kryesor për përfaqësimin e Kosovës, sepse ata veprojnë me mandat nga qeveria e tyre, janë transparentë dhe mbajnë përgjegjësi për mbrojtjen e interesit shtetëror. "Unë do të preferoja shumë më tepër të punoja me një koleg, një diplomat, për të cilin e di se përfaqëson ministrin e Jashtëm, presidentin apo kryeministrin e vendit të tij", thotë Brooks për Radion Evropa e Lirë. Ajo shpreh skepticizëm ndaj lobimit, duke theksuar se ai bart rrezik për korrupsion, krijon marrëdhënie personale dhe biznesi që nuk janë

KRYEPROKURORI GASHI PARAQET PRIORITETET PËR 100 DITËT E PARA TË MANDATIT NË KRYE TË PROKURORIT TË SHETIT

EPOKA
ERE

Qendresa RAMA

PRISHTINË, 28 KORRIK - Kryeprokurori i Shtetit, Zejnulla Gashi, ka mbajtur takimin e parë të kolegjiumit me kryeprokurorët dhe përfaqësuesit e prokurorive respektive. Të pranishëm ishin edhe prokurorët e Zyrës së Kryeprokurorit të Shtetit dhe partnerët ndërkombëtarë nga Ambasada e Britanisë së Madhe në Kosovë si dhe përfaqësues nga Programi për Çështje Ndërkombëtare të Narkotikëve dhe Zbatim të Ligjit (INL) i Ambasadës Amerikane në Kosovë. Gjatë adresimit të tij, kryeprokurori Gashi i njoftoi kryeprokurorët me prioritetet kryesore për 100 ditët e para të mandatit që, sipas tij, kërkojnë veprime të menjëhershme institucionale, ndër të cilat: Zhvillimi i hetimeve financiare krahas hetimit dhe ndjekjes penale në rastet e korrupsionit të profilit të lartë, krimin të organizuar, shpëlarjes së parave dhe krimeve të tjera të rënda; Siguria e qytetarëve, luftimi i armëmbajtjes pa leje dhe luftimi i narkotikëve; Mbrojtja e pronës së qytetarëve; Siguria ekonomike dhe juridike e qytetarëve dhe subjekteve që ushtrojnë veprimtari ekonomike; Trajtimi i rasteve të dhunës në familje dhe mbrojtja e viktimave; Mbrojtja e integritetit të hetimeve dhe të dhënave personale; Ndjekja penale dhe politike më rigoroz ndëshkimore ndaj personave përgjegjës që



rrezikojnë sigurinë në trafikun publik; Krijimi i mekanizmit të ri mbikëqyrës në kuadër të ZKPSH-së në funksion të ngritjes së cilësisë së punës brenda institucionit të Prokurorit të Shtetit, përkatësisht mbikëqyrjes së cilësisë së aktakuzave të kthyer nga gjykata, aktgjykimet liruese, dështimet procedurale, vërejtjet e gjykatave dhe praktikën gjyqësore, në respektim të plotë të pavarësisë institucionale të Prokurorit të Shtetit; Krijimi i një mekanizmi të brendshëm institucional në kuadër të ZKPSH-së për mbrojtjen

e prokurorëve në rastet kur ata atakohen padrejtësisht gjatë ushtrimit të funksionit dhe detyrave të tyre zyrtare; si dhe forcimi i komunikimit të brendshëm institucional dhe respektimi i vijës hierarkike. Këto çështje kryeprokurori Gashi i konsideroi si nevojë të kohës, të cilat synojnë rritjen e efikasitetit në ndjekjen penale, në fuqizimin e sundimit të ligjit dhe forcimin e besimit të publikut në institucionin e Prokurorit të Shtetit.

Kryeprokurori i Shtetit ka kërkuar

nga kryeprokurorët që brenda një afati të arsyeshëm kohor secila prokurori e shkallës së parë t'i paraqesë Zyrës së Kryeprokurorit të Shtetit një plan fillestar për trajtimin e çështjeve të përmendura më lart e të cilat bien në kompetencë lëndore dhe territoriale të tyre. Po në këtë takim u diskutuan edhe çështje të tjera profesionale, ndërsa kryeprokurorët dhe përfaqësuesit e prokurorive raportuan lidhur me gjendjen e përgjithshme të prokurorive të tyre, veçmas për: gjendjen me

lëndë të vjetra; efikasitetin në trajtimin e lëndëve; rastet me interes të lartë publik; sfidat kryesore të prokurorive që ata i menaxhojnë si dhe nivelin e zbatimit të SMIL-it në secilën prokurori.

Në përmbyllje të takimit, kryeprokurori Gashi garanto mbështetjen e plotë institucionale dhe u ofroi bashkëpunim të ngushtë të gjithë kryeprokurorëve dhe prokurorëve të shtetit në nivel vendi për luftimin e të gjitha formave të kriminalitetit dhe forcimin e sundimit të ligjit.

gjithmonë transparente dhe mund të mos jenë në përputhje me interesat më të gjera si të Shteteve të Bashkuara ashtu edhe të vendit që përfaqësohet. "Shpesh lobistët bëjnë gjëra që, për mua si diplomate, dukeshin më pak legjitime. Ata krijojnë marrëdhënie me zyrtarët amerikanë përmes darkave, udhëtimeve, dhuratave dhe formave të tjera të afrimit krahas ofrimit të informacionit", thotë ajo.

Sipas Brooksit, lobimi mund të jetë i dobishëm vetëm në raste të kufizuara dhe shumë specifike, kur një shtet i vogël - me kapacitete të kufizuara diplomatike - ka një objekt të caktuar që diplomatët e tij nuk mund ta mbulojnë plotësisht. Si shembuj ajo përmend zhvillimin e një programi civil të energjisë bërthamore apo hapjen e një tregu të veçantë eksporti. "Pikërisht për këtë janë lobistët - për çështje të kufizuara dhe shumë specifike", thotë Brooks. Ndaj, në vend të kontratave të reja të lobimit, ajo thotë se do të investonte në një ambasadë më të fuqishme, me më shumë diplomatë dhe kapacitete për të ndërtuar marrëdhënie të drejtpërdrejta me Kongresin,

administratën amerikane dhe qendrat e politikëbërjes.

Lobimi si mjet, jo si strategji

Në një pikë mes këtyre dy qëndrimeve është Blerim Vela, ish-shef i kabinetit të presidentes së Kosovës, Vjosa Osmani. Për të debati nuk është nëse Kosova duhet apo jo të angazhojë firma lobimi, por si duhet ta ndërtojë praninë e saj në Uashington. "Çështja e lobimit në ShBA duhet parë si një mjet për realizimin e qëllimeve në politikën e jashtme", thotë ai për Radion Evropa e Lirë. Vela, aktualisht bashkëpunëtor i jashtëm kërkimor i Qendrës për Siguri dhe Qëndrueshmëri në Oslo, argumenton se përfaqësimi i Kosovës duhet të mbështetet në tri shtylla: Ambasadën në Uashington, komunitetin shqiptaro-amerikan dhe, si element plotësues, kontratat e lobimit. Por, sipas tij, asnjëra prej tyre nuk mund të japë rezultat nëse mungon koordinimi mes Presidencës, qeverisë dhe Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe një "politikë koherente" që u jep vazhdimësi objektivave të politikës së jashtme.

Ai vlerëson se edhe mënyra se si funksionon administrata amerikane ka ndryshuar.

Vendimmarrja, thotë ai, është bërë më e centralizuar në Shtëpinë e Bardhë, çka kërkon edhe një qasje tjetër nga Kosova. "Duhet ta kuptojmë se si merren vendimet në sistemin amerikan dhe të përshtatemi me të", thotë Vela.

Ai shton se, para se të flitet për kontrata të reja lobimi, institucionet duhet ta forcojnë vetë diplomacinë. Kjo nënkupton ambasadat me më shumë diplomatë dhe objektivat të përcaktuara qartë. "Qeveria e Kosovës dhe institucionet e Kosovës duhet ta kryejnë punën e tyre. Puna e tyre primare është të sigurohen që ambasadat të jenë me numër sa më të madh diplomatësh. Pastaj, t'i përcaktojnë qëllimet", thotë ai. Por, për Velën, sfida shkon përtej marrëdhënieve me ShBA-në. Ai argumenton se krizat e brendshme politike kanë bërë që politika e jashtme e Kosovës ta humbasë vazhdimësinë dhe iniciativën, duke e bërë vendin më pak të pranishëm në skenën ndërkombëtare. "Nëse vazhdojmë me këtë qasje, do ta humbim hapin dhe pastaj do të jetë

vështirë të konsolidohet pozicioni ynë", përfundon ai.

Mësimet nga Serbia dhe Bosnjë-Hercegovina

Ndryshe nga Kosova, Serbia - e cila vazhdon ta kundërshtojë pavarësinë e Kosovës dhe të llojë kundër anëtarësimit të saj në organizata ndërkombëtare - investon në praninë e saj në Uashington. Sipas regjistrat amerikan të FARA-s, institucionet serbe dhe subjektet e lidhura me to kanë aktualisht gjashtë kontrata aktive lobimi, që mbulojnë fusha të ndryshme, nga bashkëpunimi ekonomik dhe energjetik deri te përfaqësimi i interesave politike të Beogradit.

Për Brooks-in, megjithatë, ndikimi i Serbisë nuk shpjegohet vetëm me këto kontrata. Ajo vëren se Ambasada e Serbisë në Uashington është "ndoshta pesë herë më e madhe" se ajo e Kosovës, me më shumë staf dhe burime, gjë që i mundëson të ndërtojë marrëdhënie të vazhdueshme me institucione të ndryshme amerikane. Si shembull, Brooks përmend ish-ambasadorin serb në ShBA, Marko Gjuriq, i cili gjatë një

periudhe të administratës Biden, sipas saj, kishte "qasje të drejtpërdrejta te presidenti" dhe më vonë u emërua ministër i Jashtëm. "Marko Gjuriq ishte çdo ditë në Kongres, trokiste në dyer, ndërtonte marrëdhënie, organizonte darka pune dhe bënte punën që duhej bërë. Ai mund ta bënte këtë sepse ishte mik i ngushtë me presidentin e vendit", thotë Brooks. Ajo përmend edhe Bosnjë-Hercegovinën si shembull paralajmërues se si lobimi mund të përdoret në mënyrë të gabuar. Ajo thekson se, ndonëse në ShBA janë të regjistruara 16 kontrata lobimi për Bosnjë-Hercegovinën, "shumica, në fakt, përfaqësojnë Republikën Serpska". Sipas saj, qëllimi kryesor i tyre ka qenë heqja e sanksioneve ndaj ish-liderit të entitetit serb, Millorad Dodik - një objektiv që, thotë Brooks, nuk u shërbente interesave të Bosnjë-Hercegovinës dhe nuk u zhvillua në mënyrë transparente. Për Brooks-in kjo është një kujtesë se një shtet nuk mund ta ndërtojë politikën e jashtme vetëm mbi kontrata lobimi. "Nuk dua që diplomacia të funksionojë mbi bazën e parimit 'paga për të pasur qasje'", përfundon ajo.

KRISTALET E REVOLTËS SË SYZIFIT

Lulëzim ETEMAJ

Romani *Revolta e Syzifit* i Bardhyl Mahmutit është një nga ato vepra që tejkalojnë kufijtë e letërsisë artistike dhe shndërrohen në një akt kujtese historike, morale dhe njerëzore. Duke u mbështetur në tragjedinë e Poklekut të Vjetër të 17 prillit 1999, ku policia serbe në shtëpinë e Sinan Muqollit ka vrarë dhe djegur 26 fëmijë të mitur, 5 të rinj dhe 20 gra, ndërkaq përskaq kullës së Halil Muqollit i ka pushkatuar dy burra, Sinan Muqollin dhe Ymer Elshanin, autori ndërton një rrëfim ku dokumenti historik dhe arti letrar bashkëjetojnë natyrshëm, ndërsa e vërteta historike fiton një dimension estetik dhe filozofik. Romani nuk synon vetëm të rrëfejë një krim gjenocidal, por ta ruajë kujtesën e tij dhe ta ngrejë në një përmasë universale.

Ndonëse titulli i romanit dhe ilustrimi artistik e orientojnë lexuesin drejt figurës së Syzifit, gjatë leximit bëhet e qartë se, krahas figurës së Syzifit, metafora e kristaleve fiton një rol qendror në organizimin poetik dhe etik të veprës. Pikërisht fjala kristal shndërrohet në boshtin poetik dhe emocional të rrëfimit, rreth të cilit organizohen kujtesa, filozofia, etika dhe dimensionet estetike të romanit. Në këtë metaforë përqendrohen kujtesa e viktimave, dhimbja, e vërteta historike dhe shpresa; përdërisa Syzifi simbolizon revoltën, kristalet mishërojnë shkaku moral të revoltës.

Në faqet e romanit, kristalet nuk janë vetëm një figurë poetike. Në planin metaforik, kristalet janë shndërrimi estetik i hirit dhe i mbetjeve të 51 shqiptarëve të djegur në shtëpinë-kremator të Poklekut. Përmes kësaj metafore, Bardhyl Mahmuti refuzon gjuhën e çnjerëzimit: viktimat nuk reduktohen në hi anonim, por ngrihen në rangun e diçkaje të çmuar, të pastër dhe të paprekshme nga harresa. Kjo metaforë hap disa shtresa kuptimore. Para së gjithash, ajo ua rikthen viktimave dinjitetin që krimi synoi t'ua mohonte. Kristali simbolizon pastërtinë dhe pafajësinë e tyre, por edhe qëndrueshmërinë e kujtesës. Ashtu si kristali që ruan dhe reflekton dritën, edhe kujtesa e tyre vazhdon të ndriçojë përkundër përpjekjeve për zhdukje. Në kontrast me errësirën morale të gjenocidit, kristalet bëhen shenjë e së vërtetës. Ndërsa kujtesa që ato mbartin është e qëndrueshme, vetë kristali ruan edhe idenë e brishtësisë së jetës njerëzore, duke kujtuar se viktimat ishin fëmijë, nëna, burra e pleq, jeta e të cilëve u ndërpre mizorisht nga forcat serbe.

Përmasa etike e metaforës është po aq e fuqishme. Duke zgjedhur emërtimin kristale, autori refuzon çdo gjuhë që do



t'i trajtonte viktimat si mbetje biologjike; ai i rikthen ato në qendër të ndërgjegjes njerëzore, si prani që vazhdon të kërkojë kujtim, drejtësi dhe përgjegjësi morale, politike dhe penale. Prandaj kristalet nuk e zbusin tmerrin e krimit, por e bëjnë të pamundur harresën. Shprehja "... kristalet mbi supet tona bartnin historinë e mijëra njerëzve të zhdukur..." përmbledh idenë qendrore të romanit. Kristalet tejkalojnë kuptimin e mbetjes fizike; ato bartin historinë, kujtesën dhe përgjegjësinë morale të brezave, duke u shndërruar njëherazi në dëshmi të së vërtetës historike dhe në metaforë të ndërgjegjes njerëzore.

Pikërisht në këtë plan simbolik bëhet plotësisht e kuptueshme figura e Syzifit.

Në mitologjinë greke, Sizifi është simboli i absurdit, i dënuar ta shtyjë përjetësisht gurin drejt majës së malit, pa arritur kurrë një përfundim. Albert Kamy e shndërroi këtë figurë në metaforën filozofike të absurdit të ekzistencës dhe të revoltës së njeriut përballë tij. Bardhyl Mahmuti e rimerr këtë simbol, por e transformon rrënjësisht. Syzifi i romanit nuk është figura mitologjike dhe as metafora ekzistencialiste e Kamysë. Ai është personi real, luftëtari i UÇK-së, Fadil Muqolli, i ngritur në nivelin e simbolit. Në vend të absurdit pa fund, ai mishëron kundërabordin: bindjen se përballë së keqes njeriu nuk duhet të dorëzohet, por të veprojë pa rreshtur.

Kjo bindje materializohet në barrën që ai zgjedh të mbartë: thesin me kristalet e Poklekut. Në të ka një barrë që nuk mund të matet me kandar. Në atë thes ndodhen kristalet e Lirijes gjashtëmuajshe, Qëndrimit 1 vjeç, Kushtrimit 2 vjeç, Fatosit 2 vjeç, Florentines 3 vjeç, Eronitës 4 vjeç, Egzonit 4 vjeç, Vahides 4 vjeç, Mërgimit 5 vjeç,

Albulenës 6 vjeçe, Mirsadit 7 vjeç, Agronit 10 vjeç, Ylberit 10 vjeç, Hafijes 10 vjeçe, Nderimit 11 vjeç, Mendo-hijes 12 vjeçe, Hasanit 12 vjeç, Besartit 13 vjeç, Rexhepit 13 vjeç, Abdullahut 13 vjeç, Naserit 13 vjeç, Shehides 14 vjeçe, Kujtimit 16 vjeç, Fatmires 18 vjeçe, Sherifes 18 vjeçe, Kimetes 18 vjeçe. Kristalet e pastra si loti i 26 fëmijëve, 5 të rinjve dhe 20 nënave të shtëpisë-kremator. Mbi të njëjtat supe rëndon edhe dhimbja për 1392 fëmijë shqiptarë, 1739 gra shqiptare të vrara dhe mbi 20 mijë femra e meshkuj shqiptarë të përdhunuar seksualisht gjatë luftës.

Në këtë kuptim, Syzifi i Bardhyl Mahmutit ngadhënjën mbi absurdin. Fitorja e tij nuk është fizike, sepse krimi nuk mund të zhbëhet dhe drejtësia historike ende nuk është përmbushur plotësisht. Guri vazhdon të rëndojë mbi supet e tij për aq kohë sa gjenocidi i kryer nga Serbia ndaj shqiptarëve të Kosovës nuk njihet ndërkombëtarisht. Megjithatë, ai fiton në planin moral. Duke rrezikuar jetën për t'i mbledhur kristalet nga shtëpia-kremator, ai u jep atyre mundësinë të mbijetojnë si dëshmi. Së bashku me njësitin e UÇK-së, ai i strehon në një vend të sigurt, larg mundësisë që të zhdukeshin nga forcat serbe. Pikërisht ky akt e përmbys mitin klasik të Sizifit: guri nuk shtyhet më kot, por për të shpëtuar dëshminë e krimit dhe kujtesën e viktimave.

Kristalet janë çelësi për ta kuptuar revoltën e Syzifit

Ndryshe nga guri i Sizifit të mitit, i cili rikthehet gjithnjë në pikën e nisjes, kristalet nuk rikthehen prapa. Ato barten për ta ruajtur kujtesën dhe për ta përcjellë atë brez pas brezi. Pikërisht këtu

qëndron dallimi thelbësor: revolta e Syzifit të Bardhyl Mahmutit është revoltë kundër harresës.

Duke qenë se Syzifi simbolizon revoltën, kristalet janë arsyeja dhe kuptimi i saj.

Një nga episodet më domethënëse të romanit është vizita e delegacionit të NATO-s në Poklek, më 24 mars 2000, ku merrnin pjesë sekretari i Përgjithshëm i Aleancës, lordi George Robertson, si edhe generalët Wesley Clark dhe Klaus Reinhardt. Gjatë kësaj vizite ata takojnë Elhame Muqollin, të mbijetuarën e vetme nga familja e saj e ngushtë. Në shtëpinë-kremator ishin vrarë tri motrat e saj- Albulena 6 vjeçe, Fatmirja 17 vjeçe dhe Vezirja 19 vjeçe; dy vëllezërit- Agroni 9 vjeç e gjysmë dhe Rexhepi 13 vjeç, si dhe nëna, Shemsija 42 vjeçe.

Në shenjë solidariteti dhe nderimi, Lordi George Robertson i dhuron asaj simbolin e Aleancës Veriatlantike të skalitur në kristal. Ky episod krijon një rezonancë të veçantë me metaforën qendrore të romanit. Kristali nuk është më vetëm metaforë e hirit të viktimave; ai bëhet edhe simbol i njohjes, i solidaritetit dhe i përgjegjësisë ndërkombëtare për ruajtjen e kujtesës së krimit. Në këtë mënyrë, tragjedia e Poklekut e kapërcen kufirin lokal dhe fiton një përmasë universale.

Po aq i rëndësishëm është edhe dimensionet etik të romanit. Mahmuti nuk mjaftohet me denoncimin e krimit; ai shtron edhe pyetje të vështira për kujtesën, përgjegjësinë dhe hipokrizinë shoqërore. Episodet ku kujtohen njerëz që dikur kishin propozuar t'i linin vetëm në mjediset e shkollës të plagosurat Elhamen, Feride Buqollin dhe Hata Krasniqin, që qentë e policisë serbe t'ua nuhatnin gjakun dhe ato të binin në duartë e tyre, ndërsa më vonë

vërsulen të dalin në fotografi me delegacionin e NATO-s, zbulojnë kontrastin ndërmjet oportunitizmit moral dhe sakrificës së vërtetë.

Në të njëjtën kohë, romani shndërrohet në një reflektim mbi moralin e shoqërisë sonë pas luftës, por edhe mbi mënyrën se si drejtësia ndërkombëtare u përball me krimet e kryera nga Serbia në Kosovë. Në këtë kontekst, autori ndalet te një raport autopsie i Gjykatës Penale Ndërkombëtare për ish-Jugosllavinë, në të cilin nuk thuhet asnjë fjalë për shkaku e vdekjes së viktimave. Në këtë pikë Syzifi shtrun pyetjen: "Cilat ishin arsyet politike që e detyruan këtë gjykatë të fshihte atë që e dinim fare mirë?!" Kjo pyetje nuk kërkon vetëm një përgjigje juridike; ajo shpreh zhgënjimin moral ndaj çdo përpjekjeje për ta relativizuar ose zbehur të vërtetën e krimit.

Gjuha e Bardhyl Mahmutit karakterizohet nga një ekuilibër i rrallë ndërmjet dokumentit historik dhe figurës artistike. Faktet nuk e rëndojnë rrëfimin; përkundrazi, i japin besueshmëri, ndërsa metaforat, simbolika dhe ndjeshmëria poetike e ngrejnë tekstin mbi nivelin e një kronike historike. Pikërisht metafora e kristaleve e përmbledh më së miri këtë bashkim të dokumentit me artin. *Revolta e Syzifit* është një roman që u drejtohet para së gjithash shqiptarëve, veçanërisht brezave të lindur gjatë dhe pas luftës, për t'ua bërë të njohura përmasat e gjenocidit në Kosovë. Megjithatë, mesazhi i tij nuk duhet të mbetet i kufizuar vetëm në gjuhën shqipe. Ashtu si kristalet e Poklekut bartin kujtesën e viktimave, edhe romani meriton të flasë në anglisht, gjermanisht, frëngjisht, italisht dhe në gjuhë të tjera, në mënyrë që e vërteta historike të bëhet pjesë e ndërgjegjes ndërkombëtare.

Në përmbyllje, mund të thuhet se romani i Bardhyl Mahmutit është një revoltë kundër harresës. Titulli e orienton lexuesin drejt figurës së Syzifit, por gjatë leximit bëhet e qartë se revolta e tij fiton kuptim të plotë vetëm përmes metaforës së kristaleve. Nëpërmjet tyre, autori e shndërron hirin në kujtesë, kujtesën në dritë dhe dritën në një akuzë të përhershme kundër gjenocidit të kryer nga shteti i Serbisë ndaj shqiptarëve të Kosovës. Kështu, kristalet nuk janë vetëm metafora më e fuqishme artistike e romanit; ato janë çelësi për ta kuptuar revoltën e Syzifit. Në të bashkohen dhimbja, kujtesa dhe përgjegjësia morale, duke e shndërruar revoltën nga një akt kundër absurdit, në një akt të mbrojtjes së kujtesës dhe dinjitetit njerëzor.

Në fund të fundit, romani nuk rrëfen vetëm revoltën e Syzifit; ai rrëfen udhëtimin e kristaleve. Pa to Syzifi do të mbetej një figurë e revoltës. Falë tyre, ai bëhet bartës i kujtesës.

Aleanca mban mbledhjen konstituive të Kryesisë së re: Gashtë pikat tona janë të panegociueshme

PRISHTINË, 28 KORRIK - Kryetari i Aleancës, Ardian Gjini, ka mbajtur mbledhjen konstituive të Kryesisë së re të partisë pas përfundimit të procesit të zgjedhjeve të brendshme. Ai ka bërë me dije se me kolegët e Aleancës kanë miratuar agjendën vjetore të punës dhe

planin e aktiviteteve që do të shtrihen shumë shpejt në të gjitha degët në Kosovë. “Përveç organizimit të brendshëm, diskutuam gjatë edhe për zhvillimet aktuale politike pas zgjedhjeve të përgjithshme dhe sfidat me të cilat po përballet vendi ynë.

Në këtë rrugëtim, qëndrimi ynë mbetet i qartë dhe i palëkundur: Aleanca është e përkushtuar vetëm për një proces politik që garanton stabilitet, përgjegjësi dhe orientim të qartë për Kosovën. Gjashtë pikat tona të propozuara janë parime

thelbësore për zhvillimin ekonomik dhe sigurinë kombëtare. Kushdo që synon ndërtimin e institucioneve të qëndrueshme duhet të kuptojë se këto projekte strategjike janë të panegociueshme për të ardhmen e Kosovës”, ka thënë Gjini pas kësaj mbledhje.



KONTROLLE PËR IMPORT VETURASH NGA KOREJA E JUGUT, SEKUESTROHEN PESË VETURA

MITROVICË, 28 KORRIK - Prokuroria Themelore në Mitrovicë - Departamenti i Përgjithshëm, ka njoftuar se në bashkëpunim me Doganën e Kosovës dhe Policinë e Kosovës - Njësinë për Hetimin e Autokrimeve Mitrovicë-Jug, në kuadër të një hetimi penal që është duke u zhvilluar, ka realizuar kontroll në shtëpinë e të pandehurve në Vushtrri, me qëllim të gjetjes dhe sigurimit të provave materiale relevante për procedurën penale. Veprimet hetimore janë ndërmarrë në kuadër të hetimeve lidhur me dyshimin e bazuar se të pandehurit, me dashje, në bashkëkryerje dhe në vazhdimësi, kanë falsifikuar dhe përdorur dokumente të falsifikuara publike gjatë procedurës së importimit dhe

zhdoganimit të automjeteve. Sipas dyshimeve të deritanishme, me datë 06.07.2026 të pandehurit kanë përdorur dokumente të falsifikuara - librezat koreane të automjeteve duke manipuluar të dhënat që lidhen me datën e regjistrimit të parë të automjeteve, konkretisht në dokumentet përkatëse është ndryshuar viti i regjistrimit të parë nga 2015 në 2016, me qëllim që automjetet të paraqiteshin si jo më të vjetra se dhjetë vjet dhe, në këtë mënyrë, të mundësohej importimi i tyre në Republikën e Kosovës, në kundërshtim me nenin 44, paragrafin 2 të Ligjit nr. 05/L-132 për Automjete. Dokumentet e dyshuara si të falsifikuara dyshohet se janë përdorur gjatë procedurës së importimit dhe zhdoganimit të



pesë automjeteve, me ç'rast për secilin automjet janë lëshuar Deklarata Unike Doganore (DUD), në të cilat është evidentuar në mënyrë të pasaktë se regjistrimi i parë i automjeteve

ishte bërë gjatë vitit 2016, ndonëse nga provat e siguruar deri më tani rezultojnë se regjistrimi i tyre i parë ishte bërë gjatë vitit 2015. Pesë veturat të cilave dyshohet se u janë

falsifikuar dokumentet janë sekuestruar.

Lidhur me këtë rast ekziston dyshimi i bazuar se të pandehurit, në bashkëkryerje dhe në vazhdimësi, kanë kryer veprën penale “Falsifikimi i dokumenteve”, nga neni 390, paragrafi 2, lidhur me paragrafin 1, lidhur me nenin 31 dhe nenin 77, paragrafi 1, nënparagrafët 1.2, 1.3 dhe 1.4 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës.

Prokuroria Themelore në Mitrovicë, në koordinim me Doganën e Kosovës dhe Policinë e Kosovës, do të vazhdojë ndërmarrjen e të gjitha veprimeve të nevojshme hetimore me qëllim të ndriçimit të plotë të rrethanave të këtij rasti dhe sigurimit të provave në përputhje me dispozitat e Kodit të Procedurës Penale.

SIGURIA NË FOKUS TË TAKIMEVE TË HAXHIUT DHE KURTIT ME ADMIRALIN WIKOFF

PRISHTINË, 28 KORRIK - Ushtresja e detyrës e presidentes së Kosovës, Albulena Haxhiu, ka pritur të martën në takim admiralin George M. Wikoff, komandant i Komandës Aleate të Forcave të Përbashkëta në Napoli.

Haxhiu ka bërë me dije se gjatë takimit është diskutuar për situatën e sigurisë në Kosovë dhe rajon, bashkëpunimin ndërmjet institucioneve të Kosovës dhe KFOR-it si dhe për koordinimin me NATO-n. “Sot pata kënaqësinë ta pres admiralin George M. Wikoff, komandant i Komandës Aleate të Forcave të Përbashkëta në Napoli. Biseduam për situatën e sigurisë në Kosovë dhe në rajon, për bashkëpunimin e institucioneve tona me KFOR-in dhe për rëndësinë e koordinimit të



rregullt me NATO-n. E falënderova admiralin Wikoff për angazhimin e tij, si dhe për shërbimin e KFOR-it në ruajtjen e sigurisë dhe të lirisë së lëvizjes për të gjithë qytetarët e Kosovës.

Theksova se orientimi euroatlantik i Kosovës është i pakthyeshëm dhe se anëtarësimi në NATO mbetet synimi ynë strategjik. Kosova do të vazhdojë ta forcojë bashkëpunimin me

Aleancën dhe të kontribuojë në sigurinë e rajonit”, ka shkruar Haxhiu në “Facebook”. Kryeministri në detyrë, Albin Kurti, ka bërë me dije se pas takimit të parë në janar, ka pritur

sërish në zyrë admiralin amerikan George M. Wikoff, komandant i Komandës së Forcave të Përbashkëta Aleate të NATO-s në Napoli të Italisë, i cili ishte i shoqëruar nga komandanti i KFOR-it, gjeneralmajor Özkan Ulutaş. “Ne jemi mirënjohës për përkushtimin e NATO-s për mjedis të qetë e të sigurt për të gjithë qytetarët dhe të gjitha komunitetet, si dhe për kontributin e vazhdueshëm për paqen e qëndrueshme dhe stabilitetin afatgjatë në Republikën tonë dhe mbarë rajonin e Ballkanit Perëndimor. Me admiralin Wikoff biseduam për situatën e sigurisë dhe bashkëpunimin ndërmjet institucioneve tona dhe NATO-s”, ka shkruar Kurti në rrjetet sociale.

Ekstradohet nga Kosova për në Danimarkë i kërkuari me letër rreshtim ndërkombëtar

PRISHTINË, 28 KORRIK - Policia e Kosovës, përkatësisht Drejtoria për Bashkëpunim Ndërkombëtar Policor, në bashkëpunim me njësitet e tjera relevante të Policisë së Kosovës dhe institucionet e drejtësisë, përmes aeroportit ndërkombëtar “Adem Jashari” në Prishtinë ka bërë ekstradimin e një shtetasi të Danimarkës nga

Kosova për në Danimarkë. I dyshuari ishte arrestuar nga Policia e Kosovës pasi kërkohet përmes INTERPOL-it me letër rreshtim ndërkombëtar të lëshuar nga institucionet e drejtësisë daneze, për veprat penale “Vrasje, mbajtja e armëve të zjarrit në rrethana veçanërisht rënduese dhe zjarrvënien”.

Ekstradimi u realizua bazuar në ligjet në fuqi dhe bashkëpunimin e ngushtë mes institucioneve të Republikës së Kosovës dhe atyre të Danimarkës.

Drejtoria për Bashkëpunim Ndërkombëtar Policor do ta vazhdojë shkëmbimin e informacioneve me institucionet vendore, shtetet dhe

organizatat ndërkombëtare me qëllim të parandalimit, hetimit dhe zbulimit të aktiviteteve kriminale që ndërlidhen me hetimin e kryerësve të veprave penale si dhe aktiviteteve të tjera në gjurmimin, kapjen/arrestimin e personave dhe grupeve kriminale që veprojnë brenda dhe jashtë vendit.



ATK-ja shton kontrollet në klinikat estetike, stomatologjike dhe sallonet e bukurisë

PRISHTINË, 28 KORRIK - Administrata Tatimore e Kosovës ka njoftuar se ka shtuar veprimet operative dhe kontrollet në sektorët që ofrojnë shërbime estetike, kozmetike, dermatologjike dhe stomatologjike. Sipas njoftimit, kontrollet do të fokusohen në këto kategori të bizneseve: Klinikat për

ndërhyrje estetike; Klinikat e kirurgjisë estetike; Klinikat stomatologjike; Qendrat për trajtimin e fytyrës dhe trupit; Qendrat për mbjelljen e flokëve; Sallonet e bukurisë; Qendrat e mjekësisë estetike; Qendrat e dermatologjisë; Spa dhe qendrat e wellness-it; Studiot për trajtime estetike dhe kozmetike dhe

qendrat për trajtime me laser. ATK-ja ka ftuar qytetarët dhe klientët që kanë marrë shërbime në këto biznese që të bashkëpunojnë me institucionin dhe t'i raportojnë rastet e mundshme të moslëshimit të kuponëve fiskalë apo parregullsive të tjera tatimore.



DEFICITI TREGTAR I KOSOVËS RRRITET NË 578.3 MILIONË EURO, BE-ja MBETET PARTNERJA KRYESORE TREGTARE

PRISHTINË, 28 KORRIK - Tregtia e jashtme e mallrave në Kosovë ka vijuar me rritje të deficitit tregtar gjatë muajit qershor 2026. Sipas të dhënave të publikuara nga Agjencia e Statistikave e Kosovës (ASK), deficitit arriti në 578.3 milionë euro, ose 16.1 % më shumë krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2025, kur ishte 498.3 milionë euro. Gjatë muajit qershor eksportet e mallrave u vlerësuan në 102.0 milionë euro, ndërsa importet arritën në 680.3 milionë euro. Krahasuar me një vit më parë eksportet u rritën për 26.9 %, ndërsa importet për 17.6 %. Shkalla e mbulimit të importeve nga eksportet ishte 15 %. Në strukturën e eksporteve dominojnë metalet bazë dhe produktet e tyre me 27.4 % të

totalit. Pas tyre renditen ushqimet e përgatitura, pijet dhe duhani me 12.7 %, plastika, goma dhe produktet e tyre me 10.6 %, artikujt e ndryshëm të prodhuar me 8.7 % dhe produktet minerale me 7.1 %. Sa iu përket importeve, pjesën më të madhe e zënë produktet minerale me 15.2 %, makineritë dhe pajisjet mekanike e elektrike me 13 %, mjetet e transportit me 12 %, ushqimet e përgatitura, pijet dhe duhani me 11.9 %, si dhe metalet bazë me 9.8 %. Eksportet drejt vendeve të Bashkimit Evropian arritën në 32.5 milionë euro, duke përbërë 31.9 % të eksporteve të përgjithshme dhe duke shënuar rritje prej 17.7 %. Gjermania vazhdon të jetë destinacioni kryesor i eksporteve të Kosovës në BE me 10.1 %, e



ndjekur nga Holanda me 3.8 % dhe Italia me 3.1 %. Nga ana tjetër, importet nga vendet e BE-së arritën në 304.9 milionë euro, ose 44.8 % të importeve totale, me një rritje prej 22.2 %. Peshën më të madhe e kanë importet nga Gjermania, Italia dhe Polonia. Sipas ASK-së, eksportet drejt

vendeve të CEFTA-s gjatë qershorit arritën në 44 milionë euro, ose 43.1 % të eksporteve të përgjithshme, duke shënuar rritje prej 19.3 %. Partnerët kryesorë për eksport ishin Maqedonia e Veriut me 16.7 %, Shqipëria me 14.3 %, Mali i Zi me 5.7 % dhe Serbia me 4 %.

Edhe importet nga vendet e CEFTA-s u rritën me 19.3 %, duke arritur në 98.7 milionë euro, që përfaqësojnë 14.5 % të importeve totale. Pjesëmarrjen më të madhe e kishin Maqedonia e Veriut me 5.4 %, Shqipëria me 4.8 % dhe Serbia me 3 %. Eksportet e Kosovës drejt vendeve të tjera arritën në 25.5 milionë euro ose 25 % të totalit. Në këtë grup, Zvicra mbetet partneri më i rëndësishëm me 10 % të eksporteve, e ndjekur nga Turqia me 5.4 %. Ndërkohë, importet nga vendet jashtë BE-së dhe CEFTA-s kapën vlerën e 276.7 milionë eurove, ose 40.7 % të importeve të përgjithshme. Kina renditet partnerja kryesore me 15.1 % të importeve në këtë kategori, ndërsa Turqia zë vendin e dytë me 11.6 %.

MUJA NË VJENË TAKON MINISTRIN AUSTRIAK, DISKUTOJNË PËR BUJQËSINË DHE INTEGRIMIN EVROPIAN



PRISHTINË, 28 KORRIK - Ministri në detyrë i Bujqësisë, Armend Muja, ka zhvilluar një takim në Vjenë me ministrin federal të Bujqësisë, Pylltarisë, Klimës dhe Menaxhimit të Ujërave të Austrisë, Norbert Totschnig, me të cilin ka diskutuar për thellimin e bashkëpunimit ndërmjet dy vendeve në sektorin e bujqësisë. Sipas Mujës, në takim është biseduar për hapat që Kosova po ndërmerr në procesin e integrimit evropian, me theks të veçantë për harmonizimin e politikave bujqësore dhe

sistemeve të mbështetjes me standardet e Bashkimit Evropian. Ai ka bërë me dije se pjesë e diskutimeve kanë qenë edhe forcimi i kontrollit zyrtar të ushqimit, ndërtimi i sistemeve moderne të paralajmërimit të hershëm dhe mbrojtjes nga breshëri si dhe përsheptimi i digjitalizimit të sektorit të bujqësisë. Muja theksoi se një temë e rëndësishme ishte edhe bashkëpunimi në fushën e arsimit dhe kërkimit shkencor

përmes lidhjes së instituteve bujqësore, shkëmbimit të ekspertëve, studentëve dhe stafit profesional, me synim ndërtimin e kapaciteteve dhe transferimin e përvojës austriake. Ai vlerësoi Austrinë si një partnere të rëndësishme e Kosovës në rrugën drejt Bashkimit Evropian, duke shprehur besimin se bashkëpunimi mes dy vendeve do të shtohet dhe do të sjellë rezultate konkrete për zhvillimin e bujqësisë dhe për fermerët e Kosovës.

OEK-u mbështet sektorin e gurëthyesve në adresimin e sfidave për licencim

Prishtinë, 28 korrik - Kryetari i Odës Ekonomike të Kosovës, Lulzim Rafuna, ka pritur në takim përfaqësues të bizneseve që operojnë në sektorin e gurëthyesve, me qëllim diskutimin e sfidave me të cilat po përballen në procesin e pajisjes me licenca dhe kërkesat nga institucionet përkatëse. Në takim, ku morën pjesë edhe ekspertë juridikë, u diskutuan

çështjet kryesore që ndikojnë në funksionimin e këtyre bizneseve, përfshirë vonesat administrative, pasigurinë juridike, vështirësitë në operim dhe ndikimin e tyre në punësim dhe zhvillimin ekonomik. Përfaqësuesit e bizneseve theksuan nevojën për një bashkëpunim më të koordinuar institucional dhe për zgjidhje konkrete që do të mundësonin

vazhdimësinë e veprimtarisë së tyre dhe zhvillimin e qëndrueshëm të sektorit. Oda Ekonomike e Kosovës ka theksuar se mbetet e përkushtuar për përfaqësimin dhe mbështetjen e bizneseve vendore, duke avokuar për një mjedis të favorshëm, të drejtë dhe konkurrues për zhvillimin e sektorëve të ekonomisë së Kosovës.



SHBA-ja, PROHIBICIONI DHE ALKOOLI I HELMUAR



Gjatë periudhës së Prohibicionit, qeveria e Shteteve të Bashkuara shtoi substanca toksike tek alkooli industrial, edhe pse e dinte se konsumimi i tij mund të ishte vdekjeprurës. Pasoja ishte një luftë kimike që mori mijëra jetë, kryesisht mes shtresave më të varfra të shoqërisë, dhe minoi besimin e qytetarëve ndaj shtetit.

KONSUMI, ALKOOLI DHE VDEKJET E DYSHIMTA

Muzikanti i xhazit Bix Beiderbecke po performonte në Cleveland, Ohio, në vitin 1928, kur u rrëzua papritur. Në vitet që pasuan, shëndeti i tij u përkeqësua. Edhe pse ishte i njohur si alkoolist, vdekja e tij nga pneumonia në moshën 28-vjeçare mbeti tronditëse. Disa studiues kanë hedhur hipotezën se nuk ishte vetëm infeksioni ai që i mori jetën njeriut prej kornetistëve më të mëdhenj të viteve njëzetë: ai mund të jetë helmuar.

Fajtori? Një politikë qeveritare që e bënte konsumimin e alkoolit jo vetëm të paligjshëm, por edhe potencialisht vdekjeprurës.

Gjatë Prohibicionit, periudhës kur në SHBA, nga viti 1920 deri në vitin 1933, ndaloheshin prodhimi, shitja dhe transporti i pijeve alkoolike, nuk u ndaluan të gjitha llojet e alkoolit, por vetëm ato të destinuar për

konsum, ndërsa përjashtoheshin përdorimet mjekësore dhe fetare, siç shkruhet në artikullin që sjell bota.al.

Për të penguar kontrabandistët të përdornin alkoolin industrial për prodhimin e pijeve ilegale, qeveria amerikane ndryshoi përbërjen e tij duke shtuar substanca kimike shumë toksike, si metanoli dhe benzeni. Prodhuesve që arrinin një përqindje të caktuar të këtyre aditivëve helmues madje u jepeshin edhe përjashtime fiskale.

Publiku ishte në dijeni të kësaj politike. Një titull i New York Times i asaj kohe shkruante: “Qeveria dyfishon përmbajtjen e helmit në alkool.” Kur Prohibicioni përfundoi në vitin 1933, më shumë se 10 mijë amerikanë kishin humbur jetën pasi kishin konsumuar alkool të kontaminuar.

ALKOOLI, PIJA QË HELMOI NJË BREZ TË TËRË

Rritja e kërkesës për pije alkoolike i shtyu kontrabandistët të ridistilonin dhe hollonin alkoolin industrial, në përpjekje për të eliminuar ose të pakët për të zvogëluar substancat toksike. Pasoja ishte vdekja e mijëra njerëzve, në atë që studiuesit e kanë quajtur “lufta kimike e Prohibicionit”.

Charles Norris, mjeku i parë ligjor i qytetit të Nju Jorkut, e

quajti ndotjen e alkoolit “eksperimenti ynë i shfarosjes”. Situata u përkeqësua shpejt. Në prag të Krishtlindjeve të vitit 1926, gjashtëdhjetë persona përfunduan në Bellevue Hospital të Nju Jorkut pasi kishin pirë alkool të kontaminuar. Tetë prej tyre vdiqën ditën e Krishtlindjes dhe, në fund, numri i viktimave arriti në 23, ndërsa dhjetëra të tjerë mbetën të verbër.

Norris thirri menjëherë mediat. “Qeveria e di se nuk mund ta ndalojë pirjen duke helmuar alkoolin... megjithatë vazhdon programin e saj të helmimit, edhe pse është plotësisht e vetëdijshme se njerëzit që vazhdojnë të pinë po përthithin çdo ditë atë helm.”

Ai shtoi: “Duke e ditur këtë, qeveria e Shteteve të Bashkuara duhet të mbajë përgjegjësi morale për vdekjet e shkaktuara nga pijet e helmuar.”

NJË POLITIKË ME PASOJA TË PABARABARTA

Megjithatë, jo të gjithë mendonin se politika e qeverisë ishte e gabuar.

Wayne Wheeler, këshilltar ligjor dhe figurë kyçe e Anti-Saloon League, organizata kryesore amerikane në mbështetje të Prohibicionit, argumentonte se përgjegjësia për vdekjet nuk ishte e ligjit, por e vetë konsumatorëve. “Kush pi këtë alkool industrial po kryen

vetëvrasje me vetëdije.”

Kjo deklaratë, e bërë në vitin 1926, shkaktoi reagime të forta. Senatori i New Jersey-t Edward Irving Edwards, për shembull, e quajti qeverinë “bashkëpunëtorë në krim” dhe politikën “vrasje të legalizuar”.

Ndërkohë, ndërsa qeveria e denaturonte alkoolin për ta bërë të papërshtatshëm për konsum, kriminelët vazhdonin ta shpërndanin atë, shpesh në forma edhe më të rrezikshme.

A ishte kjo vrasje? Ndoshta jo në kuptimin ligjor. Por një gjë është e sigurt: pasojat e Prohibicionit nuk i goditën të gjithë njësoj.

Qytetarët më të pasur mund të siguronin më lehtë uiski të destinuar për përdorim mjekësor, të miratuar nga qeveria dhe, për rrjedhojë, të pakontaminuar. Ata mund të konsumonin gjithashtu kokteje gjatë udhëtimeve jashtë vendit ose në kroçera.

Punëtorët dhe komunitetet afrikano-amerikane, përkundrazi, nuk kishin këto mundësi. Ata pinin atë që gjendej në tregun e zi, duke rrezikuar jetën.

“JAKE LIQUOR BLUES”

Një alternativë e njohur ndaj pijeve alkoolike ishte “Jake”, një preparat mjekësor i patentuar i njohur si Jamaica Ginger, që përmbante deri në 95% alkool. Qeveria kërkoi që shiset e shitura pa recetë të përmbanin një përqindje të lartë oleorezine,

një rrëshirë me vajra esenciale të xhenxhefilit të hidhur.

Për të përballuar kërkesën, për të mos u zbuluar dhe për ta bërë produktin më të pranueshëm në shije, prodhuesit e paligjshëm shtuan fosfat tri-orto-krezili (TOCP), një përbërje organofosforike toksike, e përdorur si plastifikues dhe ngadalësues i flakës.

Ky helm me veprim të ngadaltë sulmonte sistemin nervor, duke shkaktuar paralizë ose një ecje karakteristike çalamane që u bë e njohur si “Jake Leg”.

Edhe pse numri i saktë nuk dihet, 35 mijë amerikanë iu bashkuan United Victims of Ginger Paralysis Association (Shoqata e Viktimave të Paralizës nga Xhenxhefili), ndërsa vlerësimet flasin për 50 deri në 100 mijë persona të prekur.

Bluesmeni Ishman Bracey e përjetësoi këtë tragjedi në këngën e tij Jake Liquor Blues (1928): “Të mpin gjithë pjesën e përparme të trupit dhe nuk mund të bësh më dashuri.”

NJË LUFTË PËR TAKSAT, JO VETËM PËR MORALIN

Megjithëse Prohibicioni u paraqit si një kryqëzatë morale, ai ishte edhe një çështje politike.

Shtatë vjet më parë, Amendamenti i Gjashtëmbëdhjetë kishte vendosur tatimin federal mbi të ardhurat, duke kompensuar humbjen e të ardhurave që më parë vinin nga taksat mbi alkoolin. Denaturimi i alkoolit e bënte atë të papërshtatshëm për konsum dhe, rrjedhimisht, të patatueshëm.

Gazetarja shkencore fituese e çmimit Pulitzer Deborah Blum, autore dhe studiuese e historisë së helmeve në Amerikë, thotë: “Pas njëfarë kohe, zyrtarët e qeverisë e dinin se njerëzit po vdisnin, por nuk u ndalën.”

Ajo shton: “Nuk besoj se synimi i tyre ishte të vrisnin njerëz. Por kjo po ndodhte dhe ata e pranuan si dëm kolateral, siç ndodh në çdo luftë.”

Sipas historianes së Harvardit Lisa McGirr, kjo periudhë shënoi fillimin e zgjerimit të shtetit penal amerikan. U rritën përgjimet telefonike, burgosjet dhe fuqia e policisë federale. Siç përfundon Deborah Blum: “Janë njerëzit ata që paguajnë çmimin kur qeveritë i japin vetes autoritet moral dhe bindjen se çdo veprim është i justifikuar me arsyetimin: ‘Çdo gjë që bëj është për të mirën tuaj.’” / bota.al

ADN-ja DHE MISTERI I JETËS QË MBAN FSHEHUR

Studimi i materialit trashëgimor të çdo qenieje të gjallë, që është ADN-ja, bën të mundur zhvillimin e barnave të reja, eliminimin e sëmundjeve dhe krijimin e organizmave më pak të prekshëm. Por është e nevojshme të vendosen kufij për të shmangur eksperimente të rrezikshme.

“Kemi zbuluar sekretin e jetës.” Kështu shprehej fizikani britanik Francis Crick, i cili së bashku me biologun amerikan James Watson ndërtoi modelin e parë të strukturës së ADN-së: formën e dyfishtë spiralore të molekulës që ruan, transmeton dhe shpreh karakteristikat trashëgimore të secilit prej nesh.

Ishte 28 shkurti i vitit 1953 dhe dy studiuesit kishin zbuluar një mister që prej vitesh ua merre gjumin shkencëtarëve. Sot ai model, i ndërtuar me tela hekuri dhe karton e i bërë i famshëm nga një fotografi historike, është tejkaluar. Megjithatë ai hodhi themelet për kërkime të reja mbi strukturën e një molekule që po rezulton gjithnjë e më komplekse.

ADN-ja: Objektiv për barna të reja

Format që mund të marrë ADN-ja janë të shumta. Një grup studiuesish nga Baylor College of Medicine në Houston dhe Universiteti i Leeds kanë punuar për t'i kataloguar ato në një lloj “atlas” të paprecedentë. Falë një teknike të avancuar imazherie, të quajtur tomografi krioelektronike, dhe simulimeve të kryera me një superkompjuter, ata kanë studiuar segmente të vogla të ADN-së të mbyllura në formë rrethi, me të dy skajet e bashkuara. Zbulimi ishte se këto mikro-unaza pësojnë përdredhje dhe palosje të ndryshme, sipas artikullit të bota.al.

“Megjithëse spirala e dyfishtë është një nga imazhet më të njohura të biologjisë,” shpjegon Jonathan Fogg, një nga autorët e studimit, “kjo molekulë shumë e gjatë mund të marrë forma rrethore, tetëshe dhe madje edhe spirale.”

Kjo ndodh sepse ADN-ja duhet të “paketohet” në hapësirën tepër të vogël të bërthamës së qelizës, duke krijuar mbështjellje me të ngushta në pjesët më pak të përdorura dhe më të lira në zonat më të rëndësishme.

Vëzhgimi i këtyre mikro-unazave lejon analizimin e strukturave të ndryshme biologjikisht aktive të ADN-së. Secila prej tyre ndërvepron me

proteinat, me molekula të tjera të ADN-së ose me barna kundër kancerit, duke e përshtatur qelizën me funksionin e kërkuar.

Kjo do të thotë se, në të ardhmen, në varësi të formës së saj molekulare, ADN-ja mund të bëhet objektivi i një brezi të ri ilaçesh, të afta të depërtojnë në palosjet e molekulës dhe të veprojnë me saktësi në pikat kyçe.

Katër shkronja + dy

Që prej viteve 1960 dimë se ADN-ja e të gjitha qenieve të gjalla, nga algat deri te balenat, është një varg i gjatë udhëzimesh i koduar vetëm me katër shkronja: A, T, C dhe G, inicialet e bazave azotike që e përbëjnë. Këto udhëzime, të kombinuara në mënyra të ndryshme, shërbejnë për të ndërtuar proteinat, molekulat që garantojnë integritetin e qelizave dhe rregullojnë funksionet e tyre.

Megjithatë, një grup biologësh amerikanë nga Scripps Research Institute në La Jolla të Kalifornisë njoftoi se kishte arritur të krijonte në laborator dy baza artificiale të ADN-së, të afta të sillen në qelizë si katër bazat natyrore. Ato janë emërtuar me shkronjat X dhe Y dhe do të shërbejnë për të shkruar kode të reja, që nuk kanë ekzistuar kurrë në natyrë.

Bazat e reja u futën në ADN-në e bakterit të zakonshëm Escherichia coli, i cili jo vetëm i toleroi, por i kopjoi edhe në brezat pasues.

Për ta arritur këtë rezultat, studiuesit modifikuan ADN-në e bakterit, duke e shtyrë të prodhonte një proteinë transportuese që ndihmonte bazat e reja të futeshin në një segment të caktuar të gjenomit.

Ky “Kalë i Trojës” i gjenetikës bëri të mundur që bazat e reja t'i shpëtonin kontrollit të molekulave të veçanta “policore”, të cilat eliminojnë defektet në zinxhirët e ADN-së. Krijimi i këtij organizmi të parë të gjallë artificial hap rrugën për mundësinë e prodhimit të formave krejtësisht të reja të jetës bakteriale, të afta të bëjnë atë që ne dëshirojmë, si për shembull prodhimin e biokarburanteve. Por kjo ngre edhe një pyetje shqetësuese: çfarë organizmash të panjohur mund të krijohen në të ardhmen?

Teknika “prit dhe qep”

Aktualisht komuniteti shkencor është shumë i përfshirë në zhvillimin e një teknologjie të re për rishkrimin e ADN-së, të quajtur CRISPR-Cas9, e cila ka treguar se është në gjendje të modifikojë sipas dëshirës shprehjen e geneve të caktuara.

Një grup studiuesish nga Universiteti i Kalifornisë në



Berkeley, për shembull, arriti të ulte nivelin e kolesterolit te një grup minjsh laboratorikë.

“CRISPR-Cas9 vepron si një gërshërë molekulare, duke prerë spiralen e ADN-së në pikën e dëshiruar dhe duke zëvendësuar një segment të saj, në mënyrë që të çaktivizojë në mënyrë selektive një gjen të caktuar,” shpjegon Jennifer A. Doudna, profesore e biokimisë, biofizikës dhe biologjisë strukturore në universitetin kalifornian.

“Teknika jonë është veçanërisht e rëndësishme për të kuptuar në hollësi rolin e pjesëve të ndryshme të ADN-së dhe mënyrën se si mutacionet gjenetike shkaktojnë ndryshime në funksionet fiziologjike të qelizave.”

Kjo metodë, e cila lejon kryerjen e disa manipulimeve gjenetike njëherësh, përdoret tashmë në laboratorë në mbarë botën.

Disa studiues janë përqendruar në riprogramimin e qelizave staminale për përdorim në mjekësinë rigjeneruese; të tjerë kanë provuar të modifikojnë qelizat e bardha të gjakut për trajtimin e pacientëve të infektuar me virusin HIV.

Ai që shkoi më larg ishte gjenetisti kinez Xingxu Huang nga Universiteti i Nanjingut, i cili modifikoi gjenomin e disa qelizave të majmunëve Macaca fascicularis dhe i transferoi ato në embrione in vivo në një fazë shumë të hershme.

Nga 83 implantime, vetëm 10 çuan në shtatzëni. Të paktën gjysma përfunduan me abort spontan dhe te të vegjlit e lindur jo të gjitha qelizat ruajtën ndryshimet e dëshiruara.

Fëmijë sipas porosisë Sa i përket njeriut, përveç rreziqeve të mundshme biologjike, lind edhe një dilemë serioze etike.

Nëse CRISPR-Cas9 lejon të ndërhyhet drejtpërdrejt në ADN, duke korrigjuar sekuen-cat “e gabuara” që shkaktojnë sëmundje gjenetike pa shpresë, një ditë mund të përdoret, ashtu si po eksperimentohet te majmunët, për të “formësuar” një embrion të fekonduar in

vitro, duke i dhënë karakteristikat e dëshiruara foshnjës së ardhshme.

Rreziku është që rishkrimi i kodit gjenetik të hapë rrugën drejt një të ardhmeje të populluar nga “supernjerëz” dhe fëmijë të projektuar sipas dëshirës, por vetëm për ata që do të kenë mundësi ta përballojnë financiarisht. Pse të mos kërkohet një fëmijë me sy blu dhe flokë biondë? Apo me një tru jashtëzakonisht të zhvilluar për t'i kaluar bashkëmoshatarët? Deri tani ka mbizotëruar kujdesi.

Rreth dhjetë vende, në një listë ku nuk përfshihen Shtetet e Bashkuara, kanë ndaluar eksperimentet e bioinxhinierisë mbi ADN-në.

Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut përcakton se ndërhyrja në trashëgiminë gjenetike për qëllime jo mjekësore do të përbente një shkelje të dinjitetit njerëzor.

Megjithatë, të gjitha këto deklarata janë hartuar përpara se ndërhyrja e saktë në gjene të bëhej teknikisht e mundur. Për të kufizuar këtë rrezik, një grup prej pesë shkencëtarësh, të koordinuar nga Edward Lanphier, president i Alliance for Regenerative Medicine, i shkruan revistës Nature, duke kërkuar një moratorium ndërkombëtar për përdorimin dhe rregullimin e teknologjisë së rishkrimit të ADN-së.

Në artikull, ata u bëjnë thirrje të gjithë kolegëve të refuzojnë me vendosmëri modifikimin e embrioneve, edhe kur ai kryhet vetëm për qëllime kërkimore.

Fjalor i vogël i gjenetikës

Kromozomet

Janë strukturat që mbartin karakteristikat trashëgimore të një specieje. Ato mund të vëzhgohen në mikroskop, në bërthamën e qelizës, me anë të ngjyresve të veçantë, prej nga vjen edhe emri “kromozom”, që do të thotë “trup i ngjyrosur”. Numri i kromozomeve në bërthamën e qelizave të një specieje bimore ose shtazore

është konstant. Tek njeriu, për shembull, janë 46.

Karakteristikat trashëgimore

Janë të gjitha tiparet e dal-lueshme të një organizmi që transmetohen, të paktën pjesërisht, nga prindërit te fëmijët dhe te brezat pasues.

Gjeni

Është njësia trashëgimore që ndodhet në një pozicion të caktuar dhe të pandryshueshëm të një kromozomi të veçantë. Ai mbart informacionin trashëgimor dhe mund të pësojë ndryshime kimike ose strukturore, të quajtura mutacione, të cilat mund të ndodhin spontanisht ose si pasojë e agentëve kimikë, fizikë apo viralë.

ADN-ja

Është tërësia e geneve të pranishme në kromozomet e qelizave të një organizmi. Ajo drejton ruajtjen, transmetimin dhe shprehjen e karakteristikave trashëgimore. Nëse do të shtrihej plotësisht, një fije e vetme ADN-je do të kishte një gjatësi rreth një metër.

Gjenomi

Përcakton të gjithë grupin e geneve të pranishme në kromozomet e qelizave të një organizmi dhe përfaqëson ADN-në karakteristike të çdo specieje.

Terapia gjenike

Është trajtimi i një sëmundjeje gjenetike duke korrigjuar një ndryshim (alteracion) në gjenomin e qelizave të organizmit.

ADN-ja e gjithë botës peshon 50 miliardë ton mister i jetës

Për të vlerësuar biodiversitetin e planetit, një ekip shkencëtarësh nga Universiteti i Edinburgut zhvilloi një metodë të re: të llogarisë se sa ADN ndodhet në Tokë.

Për këtë qëllim, studiuesit klasifikuan mikrobet, kafshët, bimët, kërpudhat, viruset dhe bakteret që ekzistojnë në planet dhe llogaritën biomasën e tyre, duke e shumëzuar më pas me vlerësimin e numrit të individëve të gjallë.

Më tej, ata llogaritën numrin e qelizave që përmban secili organizëm dhe e shumëzuan këtë shifër me sasinë e ADN-së që gjendet në çdo qelizë.

Në këtë mënyrë, u vlerësua se e gjithë ADN-ja e botës do të peshonte rreth 50 miliardë ton, një sasi aq e madhe sa do të ishte në gjendje të mbushte një miliard anije kontejnerësh. / bota.al



Lazio insiston për Armando Brojën

BURNLEY, 28 KORRIK - Sulmuesi i Kombëtares së Shqipërisë, Armando Broja, mbetet objektivi kryesor i skuadrës së Lazios për fazën ofensive, kanë raportuar mediet italiane. Është raportuar në medie se drejtuesit e Lazios kanë shtuar përpjekjet për t'i

siguruar shërbimet e Brojës gjatë kësaj vere. Broja pritet të largohet nga Burnley, ekip që do të bëjë gara në Championship, ndërsa marrëveshja mes palëve mund të finalizohet së shpejti. Lazio po synon huazimin njëvjeçar të Brojës

dhe te skuadra angleze janë të gatshëm të pranojnë një ofertë të tillë, në të cilën mbetet të shihet nëse do të përfshihet detyrimi i blerjes së sulmuesit. 24-vjeçari ka kontratë me skuadrën e Burnleyt deri në vitin 2030, kurse në sezonin e

fundit Broja shënoi 1 gol dhe bëri 1 asistim në 24 ndeshje të luajtura në Premierë Ligë. Broja i është bashkuar Burnleyt verën e shkuar nga Chelsea, ndërsa karrierë ka bërë edhe tek Evertoni, Fulhami e Southamptoni në Angli.



AGIM ADEMI: JEMI NË KONTAKTE ME TRE FUTBOLLISTË QË LUAJNË NË BUNDESLIGA

PRISHTINË, 28 KORRIK - Kryetari i Federatës së Futbollit të Kosovës (FFK), Agim Ademi, ka dhënë një lajm të madh për tifozët e Kombëtares së Kosovës. I pari i FFK-së ka bërë me dije se është në bisedime me tre futbollistë që luajnë te Bayern Munichu në Bundesliga. Bëhet fjalë për Arijon Ibrahimovicin, Yll Gashin dhe Erblin Osmanin. "Jo vetëm me Arijon Ibrahimovicin, por edhe me Erblin Osmanin dhe Yll Gashin jemi në kontakte. I uroj të tre për kontratat që kanë nënshkruar dhe e falënderoj Bayernin që i ka vlerësuar. Po

më duket sikur kemi dy treshe, një te Bayerni dhe një te Hoffenheimi", ka thënë Ademi për "SportCast". Agim Ademi është takuar para disa ditësh me Ibrahimovicin në qytetin e Prizrenit, teksa me Erblin Osmanin ishte takuar javë më parë. Ibrahimovici është rikthyer këtë verë nga huazimi njëvjeçar te Heidenheimi në Bundesliga, teksa trajneri i Bayernit, Vincent Kompany, ka bërë me dije se ai do të integrohet në ekipin e parë sivjet. Ai ka kontratë me Bayernin deri në qershor të vitit 2028. Në anën tjetër,



Erblin Osmani, 17-vjeçar, është pjesë e akademisë së klubit gjerman, mirëpo debutoi me ekipin e parë në

marz të këtij viti, në Bundesliga, në fitoren e Bayernit ndaj Union Berlinit. Ai luajti për pak minuta, teksa

u bë lojtari i dytë më i ri që debutoi me fanellën bavareze. Yll Gashi, 18-vjeçar, më 2 korrik e ka vazhduar kontratën me Bayernin deri në vitin 2028. Kombëtarja e Kosovës rikthehet në aksion në muajin shtator, kur më 24 shtator do të jetë nikoqire e Republikës së Irlandës në "Fadil Vokrri", teksa në një periudhë prej dy javësh do të zhvillojë katër ndeshje gjithsej. Pas Irlandës, Kosova udhëton për tek Austria më 27 shtator, më pas do të ndeshet me Izraelin më 1 tetor, e më 4 tetor do ta presë Austrinë në Prishtinë.

BARCELONA TENTON ASLLANIN, LEIPZIGU NË PRITJE



HOFFENHEIM, 28 KORRIK - Barcelona është duke bërë një lëvizje në mënyrë që Leipzigu t'i marrë nga duart sulmuesin Fisnik Asllani, kanë raportuar mediet ndërkombëtare. Është bërë me dije se Asllani ka lënë në pritje Leipzigu për shkak të

Barcelonës, ekip që mbetet i interesuar për transferimin e tij dhe po bën gati ofertën për Hoffenheimin. Edhe pse ka marrëveshje në parim me Leipzigu, Asllani nuk po ngutet për ta finalizuar kalimin nga Hoffenheimi, pasi ka vendosur ta presë

Barcelonën përpara se ta marrë vendimin final për të ardhmen e tij. Kështu që, transferimi i Asllanit te Leipzig, që ka gjithashtu marrëveshje edhe me Hoffenheimin, mbetet në dyshim edhe për pak kohë. Asllani do të largohet këtë verë

nga Hoffenheimi, ekip që do të përfitojë 30 milionë euro nga shitja e tij, pasi sulmuesi i Kosovës ka kontratë deri në vitin 2029. Në sezonin e shkuar Asllani shkëlqeu me fanellën e Hoffenheimit, ku në 35 paraqitje shënoi 11 gola dhe bëri 10 asistime.

ZIDANE ZYRTARIZOHET NË KRYE TË KOMBËTARES SË FRANCËS

PARIS, 28 KORRIK - Zinedine Zidane edhe zyrtarisht ka marrë drejtimin e Kombëtares së Francës. Zidane është zyrtarizuar në postin e selektorit të martën në një konferencë për medie të mbajtur në Federatën e Futbollit të Francës. Në këtë post Zidane e zëvendëson Didier Deschampsin e larguar pas Botërorit 2026 dhe që në krye të Francës qëndroi prej vitit 2012.

Para se ta prezantonin Zidanen, drejtuesit e federatës kanë falënderuar Deschampsin për punën e bërë dhe sukseset e arritura me Francën përgjatë 14 vjetëve si selektor. Nën drejtimin e Deschampsit, Franca është shpallur kampione e Botës në vitin 2018 si dhe ka triumfuar në Ligën e Kombeve në sezonin 2020/21. Gjithashtu, Franca ka dalë edhe nënkampione evropiane



në vitin 2016 dhe nënkampione bote në vitin 2022. Vetë Zidane është shprehur i lumtur dhe tejet

krenar që do ta drejtojë Kombëtaren e Francës, me të cilën si futbollist ka regjistruar 108 paraqitje dhe ka shënuar 31 gola, kurse ka fituar titullin e kampionit të botës dhe Evropës në vitin 1998, përkatësisht 2000. Për Zidanen kjo është hera e parë që merr drejtimin e një kombëtareje pasi më herët ka punuar trajner te skuadra e Real Madridit në dy raste, kurse ka

genë i papunë prej vitit 2021. "Padyshim që dua të falënderoj federatën franceze për besimin, pastaj Deschampsin për punën e bërë dhe mund të them se sigurisht që kam ambicie të larta me Francën", ka thënë Zidane. Zidane do ta udhëheqë Francën në "Euro 2028" dhe Botërorin e vitit 2030 pasi me federatën franceze ka firmosur kontratë katërvjeçare.

Tre basketbollistë të Kosovës nderohen me çmime individuale nga FIBA

Prishtinë, 28 korrik - Tre basketbollistë të Kosovës janë vlerësuar me çmime individuale pas paraqitjeve të tyre në FIBA U18 EuroBasket 2026, Division C.

Besim Bytyqi është shpallur lojtari më i vlefshëm i turneut dhe njëkohësisht është përzgjedhur në formacionin më të mirë, All-Star Five. Në All-Star Five të FIBA U18

EuroBasket 2026, Division C është përfshirë edhe Lis Binishi, duke u vlerësuar për paraqitjet e tij gjatë kampionatit. Ndërsa Malvina Haziri është përzgjedhur në

All-Star Five të FIBA U18 Women's EuroBasket 2026, Division C, duke u bërë përfaqësuesja e Kosovës në ekipin më të mirë të turneut te vajzat.



NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar “Golden Gloves” SH.P.K. me seli në Mitrovicë, ka marrë vendim të shuajë biznesin me nrb UNIK: 811891995 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditore - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

OBAVESTENJE

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa “Golden Gloves” D.O.O. od Mitrovica, donelo odluku o prestani rada sa nrb. 811891995 ujedno imenovao Likvidatora o sprovođenju postupka likfidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potrazivanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

ANNOUNCEMENT

We inform al customers that the limited liability “Golden Gloves” L.L.C. with headquarters Mitrovica, has come to the decision to quit its business: 811891995 the company has appointet a liquidator wsho is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgager – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.

NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar “SB-International” SH.P.K. me seli në Prishtinë, ka marrë vendim të shuajë biznesin me nrb. 810845026 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditore - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

OBAVESTENJE

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa “SB-International” D.O.O. Pristina donelo odluku o prestani rada sa nrb. 810845026 ujedno imenovao Likvidatora o sprovođenju postupka likfidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potrazivanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

ANNOUNCEMENT

We inform al customers that the limited liability “SB-International” L.L.C. with headquarters Pristina, has come to the decision to quit its business: 810845026 the company has appointet a liquidator wsho is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgager – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.

Duke u bazuar në Ligjin Nr. 08/L-181 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, Neni 16, pika 4, “Loshi Invest” L.L.C , Istog, në bashkëpunim me Ministrin e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor dhe komunën organizojnë:

DEBAT PUBLIK

Për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për Parkun Solar fotovoltaiik “ Loshi Energy Farm” me kapacitet 0.60 MW , në Sinajë, Komuna e Istogut.

Njoftohet publiku i interesuar se më datën 15.09.2026 në ora 10:00 në objektin në Shtëpinë e Kulturës “Adem Jashari” komuna Istog, do të organizohet debat publik nga “Loshi Invest” L.L.C , Istog, në bashkëpunim me Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor dhe Komunën.

Debati Publik do të organizohet edhe në mënyrë virtuale në platformën online:

<https://us05web.zoom.us/j/7012651943?pwd=JsyiMPR68pjZDwwrm2Z53eU1x9TEbu.1>

Në linkun e mëposhtëm mund të gjeni raportin e VNM-së për vlerësimin e ndikimit në mjedis për parkun solar fotovoltaiik “Loshi Energy Farm” me kapacitet 0.60MW" nga kompania “LOSHI INVEST” L.L.C

<https://mmphi.rks-gov.net/Document/Announcements?type=2>

Në emalin e mëposhtëm mund të dërgoni komentet lidhur me projektin vnm.komente@rks-gov.net

Pjesëmarrja e juaj na ndihmon ne implementimin e projektit.

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Qamil Karavidaj shpall të pavlefshme dëftesën e shkollës fillore “Gjergj Kastrioti” në Mazdrek.

- Valmir Karavidaj shpall të pavlefshme dëftesën e shkollës fillore “Gjergj Kastrioti” në Mazdrek.

- Elton Halili shpall të pavlefshme dëftesën e klasës së 11 të shkollës së mesme të lartë të mjekësisë “Dr. Xheladin Deda”.

- Istref Hysni Nebiu shpall të pavlefshme Diplomën e Inxhinier i Diplomuar i Makineris në UB-me nr. 332.

- Shkendije Lushaj nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e sh.m.l.m.”Hysni Zajmi” Gjakovë.

- Maurita Koca nga Bishtazhini KK Gjakovë shpall të pavlefshme dëftesën e kl.10 të Gjimnazit “Hajdar Duishi” Gjakovë.

- Bedri Zeneli nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesat e kl. 10.11.12 dhe diplomën dhe certifikatën e notave të Gjimnazit “Hajdar Dushi” Gjakovë.

- Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.
- Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm.

- Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.

- Lëshohet banesa me qira ne qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.

- Lëshoj banesën e re me qera në qendër prapa teatrit Kombëtar, me sipërfaqe prej: 60 m2. Banesa ka një dhomë gjumi, sallon dhe kuzhinë. Ka të gjitha pajisjet. Çmimi: 300 €uro. Banesa lëshohet për afate të gjata dhe të shkurtra. Informata në tel: 049\44-888-801 (viber)

- Lëshoj banesë me qira, penthouse. Banesa gjendet te Rrethi i Veternikut në Prishtinë. Banesa ka 150 m2, dhe ka 3 dhoma, dy banjo, 2 garazha si dhe shpajz. Për info mund të na kontaktoni në këtë nume të tel: 049-440-466.



ROYAL CROWN
RC
cola

ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients
(Listed in alphabetical order)

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

MEKA
®
HALAL FOOD

TRADITË QË NGA 1992

